



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.3, datë 5.2.2007

**PËR
SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të të ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal", neni 16, pika 2, 3 dhe 4, neni 32, gërma "f", ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në qytetin e Tiranës si vijon:

1.1 TAKSAT VENDORE

Llojet, baza tatimore, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese dhe agjenti tatimor.

a) TAKSA MBI PASURITE E PALUAJTSHME

Taksa mbi mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:

- a.1 Taksa mbi ndërtesat
- a.2 Taksa mbi tokën bujqësore.

a.1 TAKSA MBI NDËRTESEN

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën është si vijon.

Kategoritë dhe nënkategoritë	Lekë/m2/vit
I. NDËRTESA BANIMI	
<i>Ndërtuar para 1993 – shit</i>	
Ndërtesa banimi	10.5
<i>Ndërtua pas 1993 – shit</i>	
Ndërtesa banimi	21
II. NDËRTESA TË TJERA	
<i>Ndërtesa për tregti dhe shërbime</i>	
- Ndërtesa për shërbime shëndetsore, artizanale, social kulturore, arsimore e shkencore.	140
- Ndërtesa prodhimi	140
- Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative etj	200
- Të tjera	200
<i>Të tjera</i>	
- Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve	50
- Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet.	50

Në nënkategorinë II Ndërtesa të Tjera përfshihen:

- *Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative etj të ngjashme me to:*

Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat (hotele, motele, stabiliment turistike, shtëpi pritje, turizëm familje, qendra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, bankat, zyrat, njësi tregtare dhe shërbimi të cdo lloji etj.)

- *Ndërtesa për shërbime shëndetsore, artizanale, social kulturore, arsimore e shkencore.*

Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat (farmaci, klinika, spitale, maternitete, qendra shëndetësore të të gjitha specialiteteve dhe njësitë e shërbimit artizanal si marangoz, këpucar, orëndreqës, etj të ngjashme me to).

Shkollat, kopshtet, cerdhe, qendra kulturore, qendra sociale, stadione, komplekse sportive si palestra, fitnes, pishina të hapura e të mbyllura, ndërtesa shkencore si institute kërkimore, qendra kërkimore, interneti, sallat e koncerteve, videoteka etj.

- *Ndërtesa prodhimi*

Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues si përpunim duralumini, metalesh, druri, tapecierie, letre, kartoni, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe

përpunim vajrash, nafte etj, shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to.

- *Ndërtesa të tjera*

Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat të cilat nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme.

- *Ndërtesa të tjera*

Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve

- Do të përfshihen pronat të cilat përdoren nga organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare, ambasadat të njohura ose të regjistruara si të tilla në gjykatë.

Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet

Do të kuptojmë të gjithë objektet të cilat janë kapital i Ndërmarrjeve shtetërore dhe kanë qënë kapital i ish-ndërmarrjeve shtetëror:

⇒ *Kur është objekt i ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese të cilat janë tërësisht të amortizuara (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pamvarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.*

⇒ *Kur ka qënë objekt i ish-ndërmarrjeve shtetërore të cilat janë privatizuar (tërësisht ose pjesërisht Ndërmarrja ose vetë objekti) dhe është tërësisht i amortizuara (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pamvarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.*

Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si seli të subjekteve tregtare, Taksa e Pasurisë përllëgaritet dhe paguhet si Kategoria II, Ndërtesa të tjera sipas rastit të ushtrimit të veprimtarisë duke u përjashtuar nga Kategoria e I-rë, Ndërtesa Banimi.

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Ky detyrim ndahet në 2 këste të barabarta.

Këstet e pagesës

Kësti i parë për kategorinë “Ndërtesa banimi” paguhet brenda datës 30 Qershor të vitit ndërsa për kategorinë “Ndërtesa të Tjera” brenda datës 31 Mars të vitit.

Kësti i dytë për kategorinë “Ndërtesa banimi” paguhet brenda datës 30 Shtator të viti ndërsa kësti i dytë për kategorinë “Ndërtesa të tjera” brenda datës 30 Qershor të vitit.

Lehtësirat tatimore

Taksapaguesit, për kategorinë dhe nënkategorinë e pikës I dhe II të cilët paguajnë të gjithë vlerën e detyrimit tatimor vjetor brenda datës 31 Mars të vitit, përfitojnë si kusht lehtësues reduktimin në masën prej 10 % të vlerës së detyrimit.

Agjent tatimor për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për kategorinë I “Ndërtesa Banimi” është “Njësia Bashkiake”, duke përfituar 10 % të shumës së arkëtuar. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për kategorinë “Ndërtesa të Tjera” është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës.

a.2 TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE

Taksa mbi tokën bujqësore është një detyrim vjetor. Detyrimi vjetor i taksës ndahet në këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 31 Mars të vitit dhe kësti i dytë brenda datës 30 Shtator të vitit. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Kategorite e tokes bujqesore	Lekë/ ha / vit
I	4.000
II	3.500
III	3.000
IV	2.600
V	2.100
VI	1.700
VII – X	1.300

Taksapaguesit që paguajnë të gjithë vlerën e detyrimit tatimor vjetor brenda datës 31 Mars të vitit, përfitojnë si kusht lehtësues, reduktimin në masën prej 10 % të vlerës së detyrimit.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e taksës mbi tokën bujqësore janë Njësitë Bashkiake duke përfituar 20 % të vlerës së arkëtuar.

b) TAKSA VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL

Taksa vendore mbi biznesin e vogël llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit, qoftë ky subjekt fizik apo juridik, vendas apo i huaj, me anë të të cilit realizohet një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8.000.000 lekë.

Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Tiranë.

Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël paraqiten si më poshtë:

Në 000/lekë

Nr	XHIRO/ AKTIVITET	Deri 2000	2000	3000	4000	5000	6000	7000
			- 3000	- 4000	- 5000	- 6000	- 7000	- 8000
a)	SHITJE ME PAKICË	45	68	83	98	113	128	143
a.1)	Bulmet, mish, peshk							
a.2)	Fruta, perime, ushqimore							
a.3)	Artikujt industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, etj)							
a.4)	Bar, restorant, Pub, diskoteka, lojëra fati							
a.5)	Fast food, kafe internet							
a.6)	Etj te ngjashme me to							
b)	SHITJE ME SHUMICË	45	68	83	98	113	128	143
b.1)	Magazina, dyqane etj te cilat realizojne shitje me shumice							
c)	PRODHIM	23.1	38.5	49	59.5	70	80.5	91
c 1)	Perpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie letre, kartoni, plasmasi etj te ngjashme me to							
c 2)	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gelqereje, nyje inerte etj, te ngjashme me to							
c 3)	Prodhime ushqimore, buke, embelsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh etj te ngjashme me to.							
c.4)	Prodhim konfeksione, etj te ngjashme me to.							
c 5)	Prodhim, perpunim vajrash, nafte , gazi e nenprodukte etj te ngjashme me to.							
c 6)	Impiante, territore per therrjen e kafshëve etj te ngjashme me to.							
c 7)	Shtypshkronja etj te ngjashme me to.							
c 8)	Prodhim perpunim produkte farmaceutike etj te ngjashme me to.							
d)	SHËRBIME	25	48	63	78	93	108	123
d 1)	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, radio televizore, frigorifere, lavatriçe, manjetofon, paisje fonie e te tjera te ngjashme me to.							
d 2)	Sherbime fotokopimit, sallon bukurie, autoservise, kurse per makina (autoshkolla) per traktore, per kompjuter e per parukeri, agjensi doganore, agjensi kembimi valute, agjensi turizmi, motele, pikat e sherbimit te makinave(autoservis), parkimi i makinave, lantanerite, pastrimi kimik, sherbime te rojeve civile, sallat e lojrave te ndryshme (gjimnastike, aerobie, cirqe, kende lojrash per femije, ping pong, etj.) e te tjera sherbime te ngjashme me sherbimet e lartepemendura.							

e)	PROFESIONE TË LIRA	38	60	75	90	105	120	135
e 1)	Avokatet,noter,mjek, mjeku-laborant, stomatologu, farmacisti,ekonomisti kontabel te miratuar, eksperti kontabel te autorizuar, mesuesit, veterinerit, agronomit, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, e te tjera profesione te lira te cilat ushtrohen ne njesi fikse apo ne ambiente te ndryshme.							
e 2)	Galerite e artit te piktoreve, skulptoreve dhe artisteve te tjere qe prodhojne dhe tregtojne objekte artistike							
e 3)	Institucionet jopublike te edukimit (shkollat, kopshtet apo cerdhet), sherbimet ne klinikat e specialiteteve te ndryshme mjekesore, sherbimet ne laboratore diagnostifikimi etj ne rastet kur nuk e kalojne kufirin e regjistrimit ne TVSH.							
f)	AMBULANT	8						
f 1)	Subjekte qe nuk kane nje vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante ne tregje publike dhe private.							

c) TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Baza e taksës së fjetjes në hotel, është çmimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë. Janë subjekt i Taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

Niveli i taksës është 5 % e çmimit të fjetjes.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës.

d) TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si me poshtë:

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	% e NDIKIMIT
ZONA A	
Objekte banimi, administrative, shërbimi etj.	4 %
Objekte banimi, administrative, shërbimi etj me mbi 2 kate parkim nëntokë	2 %
Objekte për qëllime publike kopshte, çerdhe, shkolla, spitale (private dhe shtetërore)	2 %
Infrastrukturë (private dhe shtetërore) si : rrugë, ujësjellës,	2 %

kanalizime, ndriçim publik, telefoni etj.	
ZONA B	
Objekte banimi	3 %
Objekte me funksione administrative, shërbimi etj.	3.5 %
Objekte banimi, administrative, shërbimi etj me mbi 2 kate parkim nëntokë	2 %
Objekte për qëllime publike kopshte, çerdhe, shkolla, spitale (private dhe shtetërore)	2 %
Infrastrukturë (private dhe shtetërore) si : rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefoni etj.	2 %
ZONA C	
Objekte banimi	2 %
Objekte me funksione administrative, shërbimi etj	2.5 %
Objekte për qëllime publike kopshte, çerdhe, shkolla, spitale (private dhe shtetërore)	2 %
Infrastrukturë (private dhe shtetërore) si : rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefoni etj.	2 %

Në rastet kur një ndërtesë ka funksione të përziera (banim dhe administrative etj) përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë dhe nënkategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqe respektive të pjesës së banimit dhe atë administrative, shërbimi etj.

Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës.

dh) TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e cila në rolin e agjentit të taksës përfitonë 3 % të shumës së arkëtuar.

e) TAKSA E RREGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE

Baza e taksës është lloji i mjetit të transportit rrugor.

Niveli i taksës shprehet në një kuotë të caktuar, sipas llojit të mjetit. Kategoritë dhe nivelet, sipas mjeteve, përcaktohen në lidhjen përkatëse të ligjit Nr.9632, dt.30.10.2006.

Agjenti tatimor për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor dhe Drejtoria e Qarkullimit Rrugor, të cilët në rolin e agjentit për taksën, përfitojnë përkatësisht 5 % dhe 1 % të shumës së arkëtuar.

ë) TAKSA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m², e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

Kategoritë dhe nënkategoritë e taksës për zënie të hapësirave publike sipas zonave të banimit jepen si në tabelën e mëposhtme:

KATEGORIA DHE NËNKATEGORITË		NIVELI TREGUES I TAKSËS/MUAJ		
		ZONA A	ZONA B	ZONA C
	Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli)			
	Nënkategoritë			
a	Organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme	150 lekë/m²	150 lekë/m²	150 lekë/m²
b	Zënia e Hapësirës publike për qëllime biznesi/tregtimi në Tregjet Publike të administruara nga Njësitë Bashkiake.	150 lekë/m²	150 lekë/m²	150 lekë/m²
c	Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash sipërfaqet e zëna me platforma , sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to.	150 lekë/m²	130 lekë/m²	120 lekë/m²

Detyrimi i taksës për llogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj.

Pagesa e Taksës për zënie të hapësirës publike:

- Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme pagesa do të bëhet me marrjen e Lejes për Ushtrimin e Aktivitetit e cila do të jepet nga Drejtoria e Dhënies së Lejeve për Ushtrim Aktiviteti. Është kjo drejtori e cila kryen dhe llogaritjen e detyrimit për lejen përkatëse.
- Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim ushtrimin e aktivitetit tregtar në Tregjet Publike që administrohen nga Njësitë Bashkiake detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Njësive Bashkiake
- Për rastin e përdorimit të truallit qëllim ushtrim aktiviteti tregtar si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, sipërfaqet e zëna me platforma , sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore

Taksapaguesit përfitojnë kushte lehtësuese kur:

- lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 6-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 5% të vlerës së detyrimit.

- lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 12-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 10% të vlerës së detyrimit.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës për zënie e hapësirës publike janë:

**Për nënkategorinë (a) Drejtoria e Dhënies së Lejeve për Ushtrim Aktiviteti
(b) Njësitë Bashkiake
(c) Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore**

f) TAKSA E TABELES

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime reklamimi.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e transportit dhe profesioneve të lira.

Kategoritë dhe niveli i taksës jepet si në tabelën e mëposhtëme .

KATEGORITE	Niveli i Taksës vjetore
I) Vendosje tabelle për qëllime identifikimi	
- Tabelë e shprehur në shqip	1.500 lekë/vit
- Tabelë e shprehur në gjuhë të huaj	3.000 lekë/vit
II) Vendosje tabelle për qëllime reklamimi (të lëvizshme dhe të palëvizshme)	
- Të zakonshme dhe të përbëra	10.000 lekë/m ² /vit
- Elektronike	15.000 lekë/m ² /vit

Në kategorinë I Vendosje tabelle për qëllime identifikimi kuptojmë të gjithë tabelat të vendosura në pamjet ballore të njësisë ku ushtrohet aktivitet, duke qënë pjesë përbërëse e saj ku evidentohet emri dhe lloji i veprimtarisë së vetë subjektit.

Në kategorinë II Vendosje tabelle për qëllime reklamimi (të lëvizshme dhe të palëvizshme) kuptojmë të gjithë tabelat të vendosura në pamje jo ballore, të vendosura në tarraca, llozhe, ballkone, të vensura në pjesë të rrugës, shtylla etj që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi për vete ose të tretë. Në këtë kategori përfshihen:

- ⇒ Vendosje tabelle të zakonshme dhe të përbëra (të lëvizshme dhe të palëvizshme) për qëllime reklamimi: do të kuptojmë të gjitha reklamat statike, ndiçuese ose jo ndiçuese, faqet murale dhe autolëvizëse dhe të gjitha reklamat e lëvizshme me fletë, pamje dy ose tre vizionëshe, elektromekanike ose pa ndriçim, faqet murale dhe autolëvizëse

⇒ Vendosje tabele elektronike (të lëvizshme dhe të palëvizshme) për qëllime reklamimi: do të kuptojmë reklamat digjitale, lineare me të gjitha elementët gjysëm përçues etj.

Detyrimi për Taksën e Tabelës është vjetor. Për kategorinë I detyrimi paguhet brenda datës 31 mars të vitit fiskal dhe kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit subjektet do të paguajnë 50 % të tij.

Për kategorinë II detyrimi paguhet brenda datës 31 mars të vitit fiskal. Kur detyrimi lind gjatë vitit fiskal (gjatë 6-mujorit të parë ose të dytë) ai paguhet në përputhje me muajt që subjekti kryen reklamimin e aktivitetit të tij.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithëshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

g) TAKSA E PËRKOHSHME E GJELBËRT (Për vitet 2007-2010)

Taksa e gjelbërt paguhet nga të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë ose ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Taksës së përkohshme të gjelbërt janë si më poshtë:

Kategoritë		Niveli i Taksës sipas llojit të aktivitetit	
		Biznes i Vogël	Biznes i Madh
		lekë/vit	lekë/vit
I	Çdo Familje		
	lekë/vit		
	200		
II	Veprimtari ekonomike të veçanta		
-	Njësi prodhimi:		
	-prodhim, përpunim ëmbëlsirash dhe produktesh ushqimore	4.000	9.000
	-prodhim, përpunimi pijesh	4.000	9.000
	-prodhim përpunim druri, mobileri, tapiceri	4.000	9.000
	-impiante, prodhim dhe përpunim metalesh	4.000	9.000
	-prodhim, përpunim, tregtim materialesh inerte	4.000	9.000
	-prodhim, përpunim qumështi dhe nënproduktesh	4.000	9.000
	-prodhim konfeksionesh	4.000	9.000
	-prodhim, përpunim i letrës, kartonave, plastmasit	4.000	9.000
	-prodhim, përpunim vajrash, naftë, gazi dhe nënproduktesh	4.000	9.000
	-impiante, territore per therrjen e kafshëve	4.000	9.000
	-shtypshkronja	4.000	9.000
	-prodhim, përpunim produktesh farmaceutike	25.000	100.000
-	Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi e tregtare dhe të tjera të ngjashme me to)	25.000	100.000
-	Njësi shërbimi:		
	-Klinika mjeksore, laboratore, farmaci, spitale, maternitete	7.000	10.000

	-Bar- Restorantet,	7.000	10.000
	-Fast-Food	5.000	7.000
	-Njësi Shërbim Non-Stop (Pub, Diskotekë etj)	10.000	12.000
	- Hotelet	10.000	12.000
	-Njësi shërbimi marangoz, rrobaqepës, këpucar, floktore, orëndreqës etj	5.000	7.000
	-Shkolla, kopështe, çerdhe, qendra kulturore, stadione, komplekse sportive, palestra, fitnes, pishina, qendra e institute kerkimore-shkencore, qendra interneti, salla koncerte-mbledhje e videoteka	7.000	10.000
III	Njësi të tjera (që nuk përfshihen në kategoritë dhe nënkategoritë si më lart)	2.500	5.000

Detyrimi për Taksën e gjelbërt është vjetor. Për kategorinë I dhe II kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit.

Afati i shlyerjes së detyrimit është 3-mujori i parë i vitit.

Për nënkategorinë “Njësi-çdo kantier ndërtimi”, llogaritja e taksës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë Bashkisë së Tiranës të kërkesës për leje shfrytëzimi.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës së përkohshme të gjelbërt është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Vetëm për kategorinë I “Familje” Agjenti tatimor është “Njësia Bashkiake” të cilat përfiton 10 % të shumës së arkëtuar.

1.2 TARIFAT VENDORE

a) TARIFA E RREGJISTRIMIT PËR VEPRIMTARI TË NDRYSHME

Tarifa e rregjistrimit paguhet vetëm një herë në momentin e kryerjes së rregjistrimit fillestar të subjektit dhe veprimtarisë së tij ekonomike pranë organit tatimor vendor.

Taksapaguesi rregjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë Bashkisë së Tiranës. Rregjistrimi për herë të parë bëhet përpara se taksapaguesi të fillojë biznesin. Gjatë këtij rregjistrimi taksapaguesi detyrohet të japë të dhënat sipas Udhëzimit përkatës:

Kategoritë dhe nivelet e tarifës së rregjistrimit janë si më poshtë:

Kategoritë	Tarifa në lekë
Për veprimtaritë private të personave fizikë ambulantë	2.000
Për personat fizikë, shtetërorë e privatë, vendas e të huaj	7.000
Për personat juridikë, shtetërorë e privatë, vendas e të huaj	12.000

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së regjistrimit për veprimtari të ndryshme është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

b) TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së Pastrimit janë të shprehura si më poshtë:

Nr.	Aktivitet	Niveli i Tarifës
I	KATEGORIA E FAMILJAREVE	2,100
II	KATEGORIA E BIZNESIT	
a)	Njësi shërbimi me shumicë ose pakicë	
	Bulmet, mish, peshk	20,000
	Fruta, perime, ushqimore	15,000
	Artikujt industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, etj)	10,000
	Pub, diskoteka, lojëra fati	20,000
	Bar, restorant, Fast food, kafe internet, etj te ngjashme me to	20,000 për cdo njësi shërbimi + 1.000 lekë/muaj/për cdo tavolinë jashtë njesisë së shërbimit/tregtimit
	Magazina, dyqane shumice etj te ngjashme me to	20,000
b)	Prodhim	
	Punime dhe perpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie, letre, kartoni, plasmasi etj te ngjashme me to.	
	Kategoria Biznes i Vogel	20,000
	Kategoria Biznes i Madh	70,000
	Kategoria Biznes Vip	150,000
	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gelqereje, gips, nyje inerte etj, te ngjashme me to	
	Kategoria Biznes i Vogel	20,000
	Kategoria Biznes i Madh	70,000
	Kategoria Biznes Vip	150,000
	Prodhime ushqimore, buke, embelsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh etj te ngjashme me to.	
	Kategoria Biznes i Vogel	20,000
	Kategoria Biznes i Madh	70,000
	Kategoria Biznes Vip	150,000
	Prodhim konfeksione, etj te ngjashme me to.	
	Kategoria Biznes i Vogel	20,000

	Kategoria Biznes i Madh	70,000
	Kategoria Biznes Vip	150,000
	Prodhim, perpunim vajtash, nafte, gazi e nenprodukte, etj te ngjashme me to	
	Kategoria Biznes i Vogel	20,000
	Kategoria Biznes i Madh	70,000
	Kategoria Biznes Vip	150,000
	Impiante, territore per therrjen e kafshëve etj te ngjashme me to	
	Kategoria Biznes i Vogel	20,000
	Kategoria Biznes i Madh	70,000
	Kategoria Biznes Vip	150,000
	Shtyshkronja etj te ngjashme me to	
	Kategoria Biznes i Vogel	20,000
	Kategoria Biznes i Madh	70,000
	Kategoria Biznes Vip	150,000
	Prodhim perpunim produkte famaceutike etj te ngjashme me to	
	Kategoria Biznes i Vogel	20,000
	Kategoria Biznes i Madh	70,000
	Kategoria Biznes Vip	150,000
	Podhime në fushën e artit (kinematografia etj te ngjashme me to)	20,000
c)	Subjekte ndërtimi	
	Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi , rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi e tregtare dhe të tjera të ngjashme me to)	100,000
	Rikonstruksione te pjeseshme	50,000
	Subjekte Ndertuese per selinë administrative	20.000
d)	Shërbime	
	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, radio televizore, frigorifere, lavatriçe, manjetofon, paisje fonie e te tjera te ngjashme me to.	
	Kategoria Biznes i Vogel	7,000
	Kategoria Biznes i Madh	20,000
	Sherbime fotokopimit, sallon bukurie, autoservise, kurse per makina (autoshkolla) per traktore, per kompjuter e per parukeri, agjensi doganore, agjensi kembimi valute, agjensi turizmi, pikat e sherbimit te makinave (autoservis), parkimi i makinave, lavanterite, pastrimi kimik, sherbime te rojeve civile, sallat e lojrave te ndryshme (gjimnastike, aerobie, cirqe, kende lojrash per femije, ping pong, etj.) e te tjera sherbime te ngjashme me sherbimet e lartepemendura.	
	Kategoria Biznes i Vogel	10,000
	Kategoria Biznes i Madh	20,000
e)	Profesione të lira	
	Avokatet, noter, mjek, mjeku-laborant, stomatologu, farmacisti, ekonomisti kontabel te miratuar, eksperti kontabel te autorizuar, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi.	
	Kategoria Biznes i Vogel	7,000

	Kategoria Biznes i Madh	20,000
	Mesuesit, veterinerit, agronomit, murator, karpentier, elektrikist e te tjera profesione te lira te cilat ushtrohen ne njesi fikse apo ne ambiente te ndryshme.	
	Galerite e artit te piktoreve, skulptoreve dhe artisteve te tjere qe prodhojne dhe tregtojne objekte artistike	
	Kategoria Biznes i Vogel	5,000
	Kategoria Biznes i Madh	20,000
f)	Insitucione arsimore, kulturore, Sportive etj	
	Universitete, Shkollat, kopshtet apo cerdhet, konvikte, kolegje, kinema,	10,000
	Insitucione sportive, ekspozita dhe panaire te ndryshme.	20,000
	Hotele, Motele, Komplekse Turistike, Pensione Shtepi pushimi, shtepi femijesh, vetëm për shërbimin e fjetjes (pa ushqim).	
	Kategoria Biznes i Vogel	1000 leke/dhome/vit
	Kategoria Biznes i Madh	1,500 leke/dhome/vit
	Hotele, Motele, Komplekse Turistike, Pensione Shtepi pushimi, shtepi femijesh. Spitale, maternitete per cdo dhome Shtetërore	50 leke/dhome/vit
g)	Mjedise Administrative (institucionet publike dhe private)	
	Private	500 leke/dhome/vit
	Shteterore	100 leke/dhome/vit
h)	Ambulant	
	Subjekte qe nuk kane nje vendndodhje fikse, taksi	1,500
i)	Të ndryshme	
1	Institucionet shtetërore të cilat kanë një shërbim të tyre, për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave	0
2	Pensionistët	100
3	Veteranët	0
4	Invalidët e punës dhe të luftës	0
5	Përfituesit e ndihmës ekonomike	100
6	Të verbërit	0
7	Të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik	0

Pagesa për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave është detyrim vjetor.

Detyrimi vjetor i taksapaguesit për **Kategorine I “Familjarët”** ndahet në 2 këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 30 Qershor të vitit dhe kësti i dytë brenda datës 30 Shtator të vitit.

Për të gjithë subjektet e tjera Kategoria II **detyrimi paguhet brenda datës 31 Mars të vitit Kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit.**

Për nënkategorinë “Njësi-çdo kantier ndërtimi”, llogaritja e tarifës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë Bashkisë së Tiranës të kërkesës për leje shfrytëzimi.

Të ardhurat e krijuara nga tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.

Lidhur me Kategorinë II, gërma (i), këto grupe duhet të dorëzojnë pranë zyrave të agjentit tatimor dëshminë e gjëndjes së tyre dhe më konkretisht:

- Për pikat 2,3,4,6,7, me kushtin që të jenë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë, përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, në çertifikatën familjare.
- Librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit, të sëmurëve paraplegjik e tetraplegjik dhe vërtetimin nga Njësia Bashkiake për përfituesit të ndihmës ekonomike.

Agjenti i ngarkuar për mbledhjen e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për familjarët është “Njësia Bashkiake”, duke përfituar 10 % të shumës së arkëtuar, ndërsa për të gjithë subjektet e tjera strukturë e ngarkuar është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

c) TARIFA E PARKIMIT TE AUTOMJETEVE

Tarifa për parkimin e automjeteve në vendparkime publike me pagesë dhe tarifa për vendqëndrime të mjeteve të liçensuara taksi, për një orë caktohet :

1. Autobusa të të gjitha llojeve 100 lekë/orë

2. Mikrobusat

- Autotaksi 8 – 10 vende 20 lekë/orë
- Minibuse të tjera, të çdo lloji 30 lekë/orë

3. Autoveturat

- Shtetërore dhe private
- | | |
|--------|--------------|
| Zona A | 100 lekë/orë |
| Zona B | 40 lekë/orë |
| Zona C | 20 lekë/orë |

4. Kamionë

- deri 3.5 tonë 10 lekë/orë
- mbi 3.5 deri 8 tonë 15 lekë/orë
- mbi 8 deri në 14 tonë 20 lekë/orë
- mbi 14 tonë 50 lekë/orë

Për subjektet që kërkojnë parkim të rezervuar pranë institucioneve të tyre publike ose private tarifa përlllogaritet duke shumëzuar vlerën sipas zonës së parkimit me koeficientin 0.7 për rezervim 12 mujor.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës së parkimit të automjeteve për parkimin e rezervuar është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës, e cila llogarit detyrimin dhe ndjek pagesat e tarifës së parkimit, pasi subjekti ka marrë lejen përkatëse nga Drejtoria e Transportit në Bashkinë e Tiranës.

Agjent i ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së parkimit të automjeteve për raste të tjera (parkim, orar ditor/jo i rezervuar) është Njësia Bashkiake përkatëse e cila përfiton 10 % të shumës së arkëtuar.

d) TARIFA TË SHËRBIMIT ADMINISTRATIV TË BASHKISË TIRANË

d.1) TARIFA TË SHËRBIMIT ARKIVOR

Tërheqje dokumentash dhe njehsim me origjinalin nga Arshiva e Bashkisë Tiranë
100 lekë/dokumenti

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën e shërbimit arkivor do të jetë Qendra e Informimit Qytetar pranë Bashkisë së Tiranës.

d.2) TARIFA PËR SHËRBIME TË STREHIMIT

- Përgatitje dokumentacioni për privatizim objektsh të kthyera në fond banese
100 lekë
- Përgatitje dokumentacioni për të pastrehët
100 lekë

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën e shërbimit të strehimit do të jetë Qendra e Informimit Qytetar pranë Bashkisë së Tiranës

d.3) TARIFA PËR SHËRBIMIN NE FUSHEN E TRANSPORTIT TE PASAGJEREVE DHE MALLRAVE DHE DHENIEN E LEJEVE PER USHTRIM AKTIVITETI

Dhënie çertifikate për transport mallrash apo pasagjerë, çertifikim teknik autobuzësh dhe taksi
2.000 lekë për automjet

Dhënie autorizimi si dhe konfirmimi për plotësimin e kushteve të autorizimit për subjektet në veprimtarinë e transportit ndërqtetas
3.000 lekë

Dhënie autorizimi për lëvizje të automjeteve brënda unazës për periudha të përkohshme
500 lekë/muaj/mjet

Leje apo çertifikatë për veprimtari servis të automjeteve, lavazheve, parkingut
10.000 lekë

Liçensë për lejimin e aktivitetit në përgatitjen e kursantëve për automjete (Autoshkolla)
5.000 lekë

Dhënie autorizimi për pikat e tregëtimit me pakicë të Karburanteve
5.000 lekë

Leje për shërbim tregëtar ambulator
2.000 lekë

Leje për shërbim tej kohës normale të punës (me orar të zgjatur të kufizuar)

5.000 lekë

Leje për shërbim 24 orësh (non stop) Bar kafe, restorant, pub, diskotekë, kazino, loja fati etj.

15.000 lekë

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën për dhënie leje ushtrim aktiviteti do të jete Qendra e Informimit Qytetar pranë Bashkisë së Tiranës

d.4) TARIFA TË INSPEKTORIATIT URBAN

Dhënie çertifikatë pastërtie për firmat e ndërtimit (leje ndërtimi dhe leje shfrytëzimi)

500 lekë

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën e Inspektoriatit Urban është Drejtoria e Kontrollit mbi Territorin.

d.5) TARIFA TË INSPEKTORIATIT VETERINAR

Çertifikatë ndërkombëtare eksport lëkure 2.000 lekë/çdo rast

Çertifikatë ndërkombëtare eksport bretkosa, kërmij dhe peshk 2.000 lekë/çdo rast

Çertifikatë ndërkombëtare për eksport leshi 2.000 lekë/çdo rast

Çertifikatë shoqërimi, qen , mace, produkte ushqimore shtazore përdorim vetijak

1.000 lekë/çdo rast

Kontroll i produkteve me origjinë shtazore për çdo makinë 1.000 lekë/çdo makinë

Kontroll dhe lëshim raporti në njësi prodhimi të produkteve dhe nënprodukteve të sallamit dhe qumështit 200 lekë / çdo rast

Çertifikatë për lejimin e konsumit të peshkut dhe produkteve të detit 2.000 lekë/çdo rast

Vulosja e mishit dhe pajisja me raport veterinar për një kre ka, lopë, buall, buallicë

200 lekë/kre

Vulosja e mishit dhe pajisja me raport veterinar për një kre mez e mushqerrë

200 lekë/kre

Vulosja e mishit dhe pajisja me raport veterinar për një kre viç

200 lekë/kre

Vulosja e mishit dhe pajisja, me raport veterinar për një kre dash, dele, çjap, dhi, derr

100 lekë/kre

Vulosja e mishit dhe pajisja me raport veterinar me një kre rurze, milor, ftuje, ftujak, qingj, kec, gic

100 lekë/kre

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën e inspektoriatit veterinar është Drejtoria e Kontrollit mbi Territorin.

d.6) TARIFA TË URBANISTIKËS

1. Tërheqje dokumentash dhe njehsim origjinali Arshiva Teknike dhe ajo e Kadastrës Urbane	100 lekë / dokum.
2. Kontrolli i piketimit të objekteve	
- për objekte deri në 3 kate mbi tokë	3.200 lekë
mbi 3 kate mbi tokë	4.800 lekë
3. Kontrolli pas përfundimit të themeleve	
- për objekte deri në 3 kate mbi tokë	3.200 lekë
mbi 3 kate mbi tokë	4.800 lekë
4. Kontrolli pas përfundimit të karabinasë	2.000 lekë për kat
5. Kontrolli i sistemimit të ambientit rrethues pas përfundimit të punimeve	
- për objekte deri në 3 kate mbi tokë	3.200 lekë
mbi 3 kate mbi tokë	4.800 lekë
6. Akt kontrolli i përfundimit të punimeve	
- për leje shfrytëzimi deri në 3 kate mbi tokë	8.000 lekë
mbi 3 kate mbi tokë	+ 1.000 lekë për kat
7. Fotokopjimi i planshetave në shkallën 1/500, 1/2000	
Format A4	400 lekë
Format A3	600 lekë
Format A2	800 lekë
Format A1	1.200 lekë
Format A0	2.000 lekë
8. Azhornimi i genplaneve (azhornimi përfshin dhe një brez 30 metra rreth pronës që azhornohet):	
8.1 Për leje ndërtimi etj	40 lekë / m ²
8.2 Për procedurë legalizimi të shtesës në ndërtime me leje	40 lekë/m ²
8.3 Për procedurë legalizimit të ndërtimeve pa leje, të vecuara dhe në zonë informale, në rastet kur ky shërbim ofrohet nga Bashkia e Tiranës ose Njësia Bashkiake	10 lekë/m ²
9. Dhënia e genplanit të paazhornuar të zonës ku do të ndërtohet për subjekte private	
A4	1.200 lekë
A3	3.200 lekë
10. Matja, përcaktimi i zonës së vendndodhjes së objektit, azhornimi i genplanit, sipas kërkesës (qera, privatizim, shitje etj)	6.000 lekë
11. Azhornime për reklama, vendosje tavolinash	2.000 lekë

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën e urbanistikës është Drejtoria e Përgjithëshme e Urbanistikës.

e) TARIFA PER SHERBIME NE DREJTORINE E PERGJITHSHME TE TAKSAVE

I. Dhënia e Vërtetimi për detyrimet vendore	200 lekë
II. Komisione për shërbimin te arka	100 lekë

ë) TARIFA PËR NJËSITË BASHKIAKE

- Lëshim vërtetimi për banor lagjeje 100 lekë
- Kryerja e procedurave për ndarje ose bashkim familjar 200 lekë
- Dhënie autorizimi për pensionistët gratis

- Vërtetim deklaratë për marrjen e kompesimit për personat e punësuar në shtet që kanë pjesëtar të familjes pa punë 50 lekë
- Shqyrtimi i dosjeve për leje ndërtimi dhe kalim për miratimin përkatës pranë Bashkisë Tiranë
 - Subjekte fizike 1.000 lekë
 - Subjekte Juridike 2.000 lekë
- Përgatitja dhe kontrolli i dokumentacionit për privatizim dhe strehim dhe përcjellja e tij pranë Bashkisë Tiranë 200 lekë
- Përgatitja dhe kontrolli i dokumentacionit për përfitimin e statusit si i pastrehë dhe përcjellja pranë Bashkisë Tiranë 100 lekë
- Tarifë për regjistrim fillestar në biblioteka 100 lekë
- Tarifë e shërbimit në tregjet publike (mirëmbajtje, ruajtje, shpenzime ujë, drita etj)

Tarifës së tregut i nënshtrohen të gjithë subjektet, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në hapsirat e tregjeve publike të cilët janë në administrim të Njësive Bashkiake.

Tarifa llogaritet si detyrim mujor i subjekteve.

Tarifa është si më poshtë:

- | | |
|----------------------|-----------------|
| - artikuj industrial | 3.500 lekë/muaj |
| - të tjera | 2.000 lekë/muaj |

Taksapaguesit përfitojnë kushte lehtësuese kur:

- Lidhin kontratë me afat 6-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 5% të vlerës së detyrimit.

- Lidhin kontratë me afat 12-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 10% të vlerës së detyrimit

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së shërbimit në tregjet publike janë Njësitë Bashkiake sipas vendndodhjes së secilit treg. Njësitë Bashkiake përfitojnë 100 % të të ardhurave të arkëtuara. Destinacioni i përdorimit të të ardhurave nga kjo tarifë është mbulimi i të gjitha shpenzimeve për administrimin e tregut.

f) TARIFA TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË:

f.1 DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.1 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

- Tarifa për largimin e mbeturinave voluminoze (inerte, dhera, skeletike etj) 1.000 lekë / ton

- Hyrja në Kopshtin Zoologjik:

Për fëmijë	50 lekë/ hyrja
Për të rritur	100 lekë/ hyrja

- Tarifë për mbjellje peme:

a) Bli ose Rrap në Rrugën e të Dashuruarve 10.000 lekë

b) Mimoza ose Ullinj në “Kopshtin e të dashuruarëve” brenda Parkut të Liqenit 7.000 lekë

Kjo Tarifë paguhet nga të gjithë qytetarët e interesuar për të kontribuar në gjelbërimin e qytetit ku simbolikisht si shërbim Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit mbjell pemën dhe vendos emrat e qytetarëve si mirënjohje për këtë kontribut.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife është Drejtoria Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit.

f.2 DREJTORIA NR.3 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

- Tarifa për vërtetime 200 lekë
- Tarifa e plotesimit të dokumentacionit për privatizim 500 lekë

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit.

f.3 QENDRA KULTURORE “TIRANA”

- Tarifa e dhënies në përdorim të sallës 10.000 lekë/ orë
- **Hyrja për shfaqjet e Cirkut**

Për shfaqjet e organizuara për kopshte e shkolla pa pagesë

Për çfaqjet e lira për publikun 200 lekë/ hyrja

- Hyrja për shfaqjet e varietes :
 - a) Në llozhë 500 lekë/ hyrja
 - b) Në aneks llozhë 300 lekë/ hyrja
 - c) Në anësore 200 lekë/ hyrja

- Hyrja për shfaqjet e baletit :
 - a) Ne llozhë 700 lekë/ hyrja
 - b) Ne aneks llozhë 500 lekë/ hyrja
 - c) Ne anësore 300 lekë/ hyrja

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës është Qendra Kulturore “TIRANA”

f.4 KLUBI SPORTIV TIRANA

- Tarifë e përdorimit të fushave të tenisit 300 lekë/orë
- Tarifë e përdorimit të palestrës 1.500 lekë/orë
- Tarifë e përdorimit të fushave të hapura të basketbollit 300 lekë/orë

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Klubi Sportiv Tirana

f.5 KLUBI I FUTBOLLIT TIRANA

- Hyrja në stadium për ndeshje, kur Klubi është organizator i veprimtarisë sportive¹:

	<u>Për ndeshje kombëtare</u>	<u>Për ndeshje ndërkombëtare</u>
a) Ne anësore	200 lekë/ hyrja	400 lekë/ hyrja
b) Ne përballë	300 lekë/ hyrja	600 lekë/ hyrja
c) Ne tribune	500 lekë/ hyrja	1000 lekë/ hyrja

Tarifa për dhënien në shfrytësim të mjediseve sportive te Stadiumit “Selman Stërmasi” për zhvillimin e aktivitetit sportiv
50.000 lekë/ ora

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Klubi Futbollit Tirana

f. 5 QËNDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa :

	<u>Kopshte</u>	<u>Çerdhe</u>
Tarifë për Ushqimin	110 lekë/ditë/femijë	85 lekë/ditë/femijë

Detyrimi mujor përbëhet nga Tarifa fikse dhe Tarifa për Ushqimin, ku kjo e fundit përlogaritet me nivelin ditor të tarifës dhe ditët e frekuentimit të fëmijës në çerdhe/kopsht gjatë 1 muaji.

¹ Sipas nenit 30 të Ligjit Nr. 9376, datë 21.04.2005 „Për sportin“

Përfitojnë reduktim të detyrimit mujor ose shërbim pa pagesë kategoritë e mëposhtme:

1. Familjet, të cilat kanë më shumë se 1 fëmijë në çerdhe dhe/ose kopshte:

- | | |
|-------------------------|-----------------------------------|
| 1.1 për fëmijën e dytë | 50 % reduktim nga detyrimi mujor |
| 1.2 për fëmijën e tretë | 100 % reduktim nga detyrimi mujor |

2. Familje në nevojë si më poshtë përfitojnë shërbim pa pagesë:

- 1.1 Fëmijë me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda (sëmundje gjaku, sëmundje të brendshme), sipas raportit të Komisionit Mjeko-Ligjor.
- 1.2 Fëmijë të vajzave - nëna, sipas statusit në regjistrat e Gjendjes Civile.
- 1.3 Fëmijë të familjeve, ku kryefamiljare është gruaja e ve (sipas çertifikatës të gjendjes familjare), familjet ku kryefamiljare është gruaja e divorcuar (sipas çertifikatës të gjendjes familjare), por që është në/nën pagën minimale në shkallë vendi me dokumentacionin përkatës.
- 1.4 Fëmijë të familjeve ku kryefamiljari është më paaftësi fizike ose mendore sipas raportit të Komisionit Mjeko-Ligjor.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.

f.6 NDËRMARRJA E PËRPUNIM PLEHUT

Tarifa për depozitim të mbeturinave në fushën e Sharrës 95 Lekë / ton

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës është Ndërmarrja e Përpunim Plehut.

2. Për institucionet kulturore dhe sportive, të ardhurat e krijuara nga çmimet e biletave, përveçse atyre të parashikuara shprehimisht në akte ligjore të veçanta, të ndahen si më poshtë:
 - 90 % e të ardhurave në favor të Institucionit kulturor dhe sportiv
 - 10 % e të ardhurave në buxhetin e Bashkisë së Tiranës.
3. me perjashtim të pikes 2 të këtij Vendimi, të gjitha institucionet në vartësi të Bashkisë së Tiranës që krijojnë të ardhura nga veprimtaria e tyre, i derdhen këto të ardhura 100% për llogari të Bashkisë së Tiranës.
4. Për efekt të llogaritjes së detyrimit tatimor për Taksat dhe Tarifat Vendore të këtij Vendimi, Zonat A, B dhe C janë të përcaktuara sipas hartës bashkëlidhur këtij Vendimi.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Kontrollit mbi Territorit dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Njësitë Bashkiake dhe Institucionet e varësisë.
6. Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr.7, datë 07.03.2003 me ndryshimet, VKB Nnr.64, datë 08.11.2005 dhe çdo akt tjetër që është në kundërshtim me këtë Vendim, shfuqizohen.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI

Dixhitalizuar nga Qendra per Qeshtjet e Informimit Publik , QIP
www.infocip.org
www.vendime.al